



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimë / Deregizuar Punëdhënësi / Profilito Received / Delivery	11.02	2	viti god year
Organ / Mjesia Organ / Jedinstvo Org / Unit	Hi Prof Hi Prof Prof No	Shtojtja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	699/2022		1,5



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.40/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2299/2021 të datës 13.01.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.682/2021, të datës 26.07.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë, rruga

Komuna e Lipjanit, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 10.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.682/2021 e datës 26.07.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi është i punësuar në Policinë e Kosovës, në pozitën "Asistent administrativ" në Zyrën e Drejtorit të Divizionit të komunikacionit rrugor në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë në Prishtinë, sipas kontratës së punës të datës 08.06.2012. Ankuesi me datën 04.06.2021, ka parashtruar kërkesë, tek Drejtoria e Personelit për pagesën e shujtës ditore, pagën e 13-të (për vitin 2018, 2019 dhe 2020) shtesën në pagë për kualifikimin shkollor, shtesën në pagë për 0.5% te pagës për çdo vit në mënyrë retroaktive që nga viti 2018, komfor Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës. Drejtoria e Personelit me datën 25.06.2021 i është përgjigjur ankuesit se refuzohet kërkesa e tij për kompensim për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore nga ana e Policisë së Kosovës.

Ankuesi i pa kënaqur me përgjigjen e datës 25.06.2021, nga Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës, me datën 26.07.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e shujtës

ditore, pagës së 13-të, shtesën në pagë për kualifikimin shkollor, nga viti 2018 deri 2020, si dhe shtesën në pagë për 0.5 % të pagës për çdo vit me retroaktiv nga viti 2018 e tutje, respektivisht nga hyrja në fuqi e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 29.07.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Me datën 13.08.2021, Policia e Kosovës përmes Departamentit për Burime Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 06.09.2021 përmes Njoftimit me Nr.Prot:4500/2021, ka njoftuar ankuesin se nuk mund të vendos lidhur me ankesën A.nr.682/2021 të datës 26.07.2021, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar të njëjtin mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datën 13.01.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.2299/21, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke anuluar njoftimin e datës 06.09.2021 të KPMSHCK-së dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit me numër A.nr.682/2020 të datës 26.07.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 26.07.2021, e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në kërkesë e datës 25.06.2021, nga Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës; Kërkesë për kompensim e ankuesit e datës 04.06.2021; E-maili zyrtar mi datës 04.06.2021; Vërtetim punësimi i ankuesit i datës 19.04.2021; Diplomë e ankuesit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018 për ankuesin; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019 për ankuesin; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulet dhe profesional për vitin 2020; ID zyrtare e ankuesit ne institucionin e Policisë së Kosovës; ID e ankuesit; Kërkesa për përgjigje ne ankese e datës 28.07.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankese e datës 13.08.2021 nga Policia e Kosovës; Kontratë pune për kohë të caktuar/pa caktuar e ankuesit e datës 08.06.2012 së bashku me formularin mbi përshkrimin e detyrave të punës; E-maili zyrtar i datës 04.06.2021; E-maili zyrtar i datës 22.04.2021; E-maili zyrtar i datës 20.04.2021; E-maili zyrtar i datës 20.04.2021 Aktgjykimin me numër A.nr.2299/2021 i datës 13.01.2021 nga Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, i pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 21.01.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët , ka vërtetuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me kompensimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesën në pagë për

kualifikimin shkollor, nga viti 2018 deri 2020, si dhe shtesën në pagë për 0.5 % te pagës për çdo vit me retroaktiv nga viti 2018 e tutje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili mban pozitën "Asistent administrativ", në Zyrën e Drejtorit të Divizionit të komunikacionit rrugor në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë në Prishtinë në Policinë e Kosovës, ka konstatuar se, duke u bazuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës së ankuesit në Policinë e Kosovës, në bazë të nenit 3 paragrafit 5 të Ligjit Nr.3/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ankuesi është nëpunës civil i punësuar në Policinë e Kosovës, siç e përcakton kjo dispozitë: *"5. Personeli civil i punësuar në Policinë e Kosovës, në Forcën e Sigurisë së Kosovës, në Doganat e Kosovës, në Shërbimin Korrektues të Kosovës, është pjesë e shërbimit civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi"*, që në kohën kur është miratuar Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës dhe aktet nënligjore që zbatohen për këtë fushë, respektivisht neni 4 paragrafi 1, të këtij ligji, i cili ka përjashtuar vetëm zyrtarët policor nga shërbimi civil në Policinë së Kosovës, mbi këtë bazë për veç tjerash të gjitha pagat e nëpunësve civil dhe shtesat e nëpunësve civil të Policisë së Kosovës, rregullohen në bazë të nenit 4 paragrafi 1 dhe paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, të cilat ende kanë fuqi ligjore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në nenin 44 paragrafi 2 si dhe duke u ndërlidhur me nenin 55 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, me të cilat dispozita Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, ka kompetencë për nxjerrjen e akteve nënligjore, konstaton se, me qenë se ekziston baza ligjore që e rregullon çështjen e pagave dhe shtesave të ndryshme të nëpunësve civil, siç është Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, rrjedhimisht dispozitat e lartë cekura të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, nuk i përcaktojnë dispozitat ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore, për kompensimet e shtesave në pagë, për nëpunësit civil apo stafit civil në Policinë e Kosovës.

Lidhur më këtë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka konstatuar se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datën 13.05.2010 ka aprovuar Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, i cili me dispozitën e nenit 14 të këtij ligji, ka përcaktuar se: **1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut"**, si dhe nenit 4 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensimet e tjera, mbi pagën bazë të nëpunësve civilë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se, bazuar në kompetencën e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, të përcaktuar në nenin 55 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, nuk ka marrë për bazë dispozitat e nenit 14 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, si dhe nenit 4 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, me rastin e nxjerrjes së Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, sepse në dispozitat e këtij udhëzimi janë përfshirë edhe shtesat

e tjera, të cilat në raport me dispozitat e ligjit për paga që është në fuqi, për nëpunësit civil gjegjësit stafit civil në Policinë e Kosovës, i cili si i tillë nuk është i zbatueshëm.

Lidhur me zbatueshmërinë e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, me datën 13.08.2021 Policia e Kosovës, ka dhënë përgjigje në ankesën e ankuesit me numër protokolli 4216/21 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në të cilën është deklaruar se për zbatimin e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, Policia e Kosovës ka bërë përpjekje për buxhet shtesë tek Ministria përgjegjëse me datën 24.10.2017, duke parashtruar kërkesë tek Ministria e Financave, përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme, për sigurimin e mjeteve buxhetore sipas Qarkores me numër ref.2018/02 për periudhën 2018/2020 për shtesa në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, dhe e cila kërkesë nuk është aprovuar nga Ministria e Financave. Në rastin konkret me këtë deklarim Policia e Kosovës, ka vërtetuar se para se ta miratojë Udhëzimin Administrativ të datës 14.11.2016, ka kërkuar bashkëpunim nga Ministria përgjegjëse për zbatimin e udhëzimit administrativ duke përfshirë dhe buxhetin shtesë për vitin 2018/2020, dhe nuk ka marrë aprovim për këtë çështje.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se, Policia e Kosovës edhe për kundër faktit të mos aprovimit të kërkesës së datës 24.10.2017 nga Ministria e Financave, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, duke vepruar në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 19 paragrafi 1 dhe 2 si dhe nenin 23 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: *"1. Institucionet e administratës publike çdo vit, së bashku me kërkesën vjetore për buxhet, dorëzojnë në ministrinë përgjegjëse për financa shumën e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve për shtesat mbi pagën bazë në institucionin përkatës. 2. Institucionet e administratës publike çdo vit mund t'i paguajnë shtesa stafit të tyre vetëm me kusht që shumën e përgjithshme të shtesave dhe pagave bazë të jetë përcaktuar nga ministria përgjegjëse për financa, brenda llogarisë së përgjithshme të përcaktuara për institucionin përkatës"*, dhe nenin 23 *"Institucionet e administratës publike çdo vit, së bashku me kërkesën vjetore për buxhet, dorëzojnë në ministrinë përgjegjëse për financa shumën buxhetore të nevojshme për kompensimin dhe pagesat e tjera për institucionin përkatës"*, që në rastin konkret Policia e Kosovës, mbi këtë bazë nuk ka dëshmuar me asnjë provë se a ekziston miratimi i Ministrisë përgjegjëse për zbatim të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, bazuar në planifikimin buxhetor.

Bazuar në të gjitha këto dispozita ligjore, meqenëse Policia e Kosovës nuk ka marrë aprovimin nga Ministria e Administratës Publike dhe Financave, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se edhe pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara.


Po ashtu, bazuar në dispozitën ligjore në fuqi gjegjësisht të nenit 85 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, ku përcaktohet se: *" Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj"*, i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit GJK-KO203/19-AKV të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shfuqizuar Ligjin për Shërbimin Civil Nr. 03/L-149 dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me këtë ligj, rrjedhimisht shfuqizohet cdo akt tjetër

që është në kundërshtim me këtë ligj, duke përfshirë edhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, që është nxjerrë në kundërshtim me këtë ligj, ndërlidhur edhe me dispozitat transitorë të nenit 83 për dispozitat transitorë, të këtij ligji, ku përcakton se: "1. Nëpunësi civil në marrëdhënie pune në Shërbimin Civil, në pajtim me Ligjin e Shërbimit Civil (03/L-149) dhe që mban një pozitë ekuivalente me pozitën e nëpunësve civilë sa i përket funksioneve dhe përgjegjësi, konsiderohet nëpunës civil sipas nenit 2, paragrafi 3 të këtij ligji, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji".

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.40/2022

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtarit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

